

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

KOSTT

Raport për tremujorin e katërt 2011

(01.10.2011-31.12.2011)

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Shpresa Kursani	Fadil Ismajli KSHE	Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada
Nënshkrimi			
Data	<i>Janar, 2012</i>		

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Tetor - Dhjetor 2011

1	Titulli i Dokumentit	Raport Tremujor 2011
2	Dërguesi i dokumentit	Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Kapitulli 1: Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bërë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2011</p> <p>Kapitulli 2: Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare</p> <p>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Kyç të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit</p> <p>2.2. Raport i operimit të tregut</p> <p>2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT</p> <p>2.4. Çështjet rregullative</p> <p>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare</p> <p>2.5.1. Pasqyrat financiare (Balanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë tremujorit të katërt të vitit 2011)</p> <p>2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p>Kapitulli 3 : Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>Kapitulli 4: Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të katërt të vitit 2011 nga burimet e KOSTT</p> <p>Shtojcë 1: Raporti për funksionimin e qeverisjes korporative</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Hyrje

Raporti tremujori Tetor – Dhjetor 2011 përmban të gjitha elemente konform nenit 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar (“tremujori përkatës”) i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të katërt të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transaksionet e konsiderueshme të tremujorit të katërt, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet funksionimin e qeverisjes korporative të KOSTT-it.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nenin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të katërt 2011

1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 8 (tetë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT janë të përfshirë edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv, 2 (dy) Zëvendës të KSHE, njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Sekretarit të Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënies me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun dhe
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


1.2. Numri i Punëtorëve

Me datën 1 tetor 2011 numri i punëtorëve në KOSTT ka qenë 241, ndërsa më 31 dhjetor 2011 numri i përgjithshëm i të punësuarve është 242.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur lëvizje të numrit të punëtorëve për këto arsye:

- 2 (dy) punëtorë janë pensionuar gjatë muajit tetor 2011 si dhe
 - 3 (tre) punëtorë të ri kanë themeluar marrëdhënie pune:
- 2 (dy) punëtorë me datën 14 nëntor 2011 dhe
- 1 (një) punëtore me datën 1 dhjetor 2011

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it



	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare

2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmissiionit për Indikatorët Teknik të Performancës


2.1.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Tetor-Dhjetor 2011

	Muajt MWh	Tetor-Dhjetor		
		E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
1	TC Kosova A	380 880	626 738	164,55
2	TC Kosova B	715 500	621 935	86,92
3	HC Ujmani	22 000	14 591	66,32
4	HC Lumbardhi	5 344	3 026	56,63
5	(1+2+3) Prodhimi gjithsejt	1 118 380	1 263 265	112,95
6	Devijimi	0	10 505	
7	Eksporti	0	6 610	
8	Importi	270 075	373 939	138,46
9	(5-6-7+8) Energjia në disponim	1 388 455	1 620 089	116,68
10	Distribucioni	1 233 545	1 292 192	104,75
11	Ferronikeli	170 963	158 498	92,71
12	Trepça	7 500	6 423	85,64
13	Sharri	14 000	16 946	121,05
14	Mihjet, Kosova Thengjilli	35 100		
15	Shpenzimet e gjen.nga transm.(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)		117 255	
16	(10+11+12+13+14+15) Kërkesa neto	1 461 108	1 591 315	108,91
17	Humbjet në transmission	45 242	28 767	63,58
18	(16+17) Kërkesa gjithsej	1 506 350	1 620 082	107,55


Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:


Balanca e planifikuar Tetor-Dhjetor 2011



Balanca e realizuar Tetor-Dhjetor 2011



Diagrami i bilancit të realizuar elektroenergjetik Tetor - Djetor 2011 (GWh)



	RAPORT TREFUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.1.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr	Indikator		2010	2011	2011/2010(%)	Caku	Komenti
			Tetor-Dhjetor 2010	Tetor-Dhjetor 2011			
T1	Energjia e transmetuar (GWh)		2278,08	2129,90	93,50	Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision	Caku nuk vendoset për këtë IKP,
T2	Piku koincident (MW)		1080	1150	106,48	Caku: 1100MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011).	Caku nuk vendoset për këtë IKP,
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	400 kV	181,815	188,49	103,67	= > 1	Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit.
		220 kV	231,882	231,83	99,98		
		110 kV	672,1085	764,94	113,81		
T4	MVA-km	400 kV	239450	248249	103,67	= > 1	Caku është si në T3
		220 kV	77506	77506	100,00		
		110 kV	78279	83209	106,30		
T5	Kapaciteti i transformatorëve	400-220; 400-110 kV	1500	1800	120,00	= > 1	Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		220-110 kV	1050	1350	128,57		
T6	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T7	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T8	Pagesa për kongestion						KOSTT do të filloj kur ATC do të alokohet nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike.
T9	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit)		25,23	71,41	283,02	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen aktuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1	AIT (Koha mesatare e rënjes) 25,23 minuta gjatë tre muajve Tetor-Dhjetor 2010, ndërsa 71,41 minuta për periudhen e njëjtë 2011
T10	Numri i ankesave për tension		0	0		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraparak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë.
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	0	0		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		Më pak se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e).
		Më shumë se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	
T12	Numri i ankesave për matje			0			
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë		0		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	
		Më shumë se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	23,10	26,07	112,86	20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		Eksport	15,44	26,14	169,28	20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar	
T15	Humbjet në transmision (GWh)		36,11	28,77	79,68		Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë më të vogla në periudhën Tetor-Dhjetor 2011 se sa në periudhën Tetor-Dhjetor 2010

AIT = (8760*60*ENS)/TE

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.1.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

Nr	Indikator	Niveli i tensionit	2010	2011	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV	Tetor-Dhjetor	Tetor-Dhjetor	2011/2010 (%)	< = 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.00	0	> 1	Performancë negative
		220	0.00	1.73	0		
		110	0.15	0.41	273.3333		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.00	0.00	0	> 1	Performancë negative
		220	0.00	4.42	0		
		110	2.32	2.51	108.1897		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.00	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0	0.00	0		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0	0.00	0		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0	0.00	0		

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0	0.00	0		
		110	1.84	0.00	0		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0	0.00	0		
		110	3.2	0.00	0		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0	0.00	0		
		110	1.71	0.00	0		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.00	0		
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.00	0.00	92.33	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	36.2		
		110	0.00	0.00	0		
T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.00	0		

Spjegim: Indikatorët T1 dhe T2, paraqesin performancë negative me që ka ardhur deri te rritja e rënieve të linjave si pasojë e çështjeve teknike si dhe dështimi i polit të ndërprerësit të fuqisë, në fushën e LP 445/2, si pasojë e defektit nga prodhuesi.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.2. Raport mbi operimin e tregut

2.2.1. Madhësia e Tregut


Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është e rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por meqenëse nuk ka furnizues tjerë të licencuar Feronikeli është furnizuar nga furnizuesi publik me kontratë me çmim të rregulluar. Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë dhe sipas ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Është arritur marrëveshje midis KEK, Feronikelit dhe ZRrE që Feronikeli të furnizohet nga KEK me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet në këtë tremujor si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmisioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit.

Konsumi tarifor (pa Feronikelin) në nivel me pakicë në Tetor-Dhjetor'11 ishte mesatarisht rreth 82.70% të konsumit të përgjithshëm bruto (duke mos përfshirë humbjet në transmision).

Në figurën në vijim është paraqitur figurativisht madhësia e tregut të rregulluar (tarifor) në raport me tregun e parregulluar. Konsumi i KEK nga rrjeti i transmisionit për nevoja vetjake, i cili është i veçantë nga tregu tarifor dhe ai jo-tarifor është i paraqitur gjithashtu në figurë


Tregu tarifor dhe jo tarifor në raport me konsumin




Në vazhdim është paraqitur bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT. Siç shihet, mbi 20.70% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja regjionale dhe për këtë shërbim KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC-së nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).

Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues për Tetor-Dhjetor 2011

Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues



Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision



	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në tabelë janë dhënë çmimet e rregulluara dhe të parregulluara në tregun e energjisë elektrike në Kosovë. Çmimet e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë janë marrë nga modelet tarifore 2009, 2010, 2011.

Në çmimin mesatar të sistemit ndikon dukshëm sasia e importit dhe çmimi i tij. Si shihet nga tabela çmimi i importit të energjisë elektrike ka pasur rënie dhe si pasojë edhe çmimi i ponderuar i energjisë elektrike ka pasur rënie nga viti 2009 deri në vitin 2010, ndërsa në vitin 2011 kemi ngritje të çmimit mesatar të sistemit ku një nga arsyet është edhe ngritja e çmimit të importit për këtë tremujor.

Çmimet e rregulluara dhe të parregulluara energjisë elektrike

		2009 €/MWh	2010 €/MWh	2011 €/MWh
Çmimet e rregulluara	Kosova B	23.32	23.35	24.4
	Kosova A	23.32	23.35	24.4
	HC Ujmani	24	27.4	27.5
	HC Lumbardhi	40	40	40
Çmimet e parregulluara	Importi-- çmimi mesatar	75,89	57,95	74.82
	Eksporti-- çmimi mesatar	20,17	26,45	36.57
Çmimi mesatar i ponderuar i sistemit		25,78	24,15	35.19

	RAPORT TËRIMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

	Projekti	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontrates	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Realizimi: (i.) Progresi, (ii.) rreziku dhe pengesat	Rekomandimet
1	<i>Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV - Kosova A</i>	10,334,070.00 €	BKK / KfW	9,881,052.73 €	17.12.2007	16.12.2009	Siemens (Ar)	Kontraktori ka kryer obligimet konform raportit të komisionit intern të KOSTT dhe pas vlerësimit nga ana e komisionit intern më 27.12.2011 është lëshuar Certifikata Finale e Pranimit (FAC), me ç' rast periudha garantuese ka përfunduar me këtë datë	
2	<i>Paket Projekti i NS 400/110 kV - Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV</i>	23.343.233,00 €	BKK / KfW	21.562.716,00 € (pa taksa)	10.06.2008	15.03.2010	Siemens & Umel (B&H)	Gjatë kuartalit të katërt, Siemensi ka vazhduar punët në eliminimin e vërejtjeve, gjegjësisht punët rreth rrafshimit të terenit në NS Peja 3 si dhe në përmbyllje të liferimit të pajisjeve rezervë. Gjatë kësaj kohe janë mbajtur takimet me personat përgjegjës të financave nga ana e kontraktuesit, stafin e financave të KOSTT dhe safit të menxhimit të projektit rreth realizimit të obligimeve ndaj kontraktuesit përfshirë edhe realizimin e disbursimit të mjeteve për pagesën e TVSH (për faturat e vitit 2009 dhe 2010), të cilën e ka paguar Siemens si dhe realizimin e pagesave tjera . Siemensi ka përmbyllur punët rreth eliminimit të vërejtjeve në NS Peja 3 si dhe në përmbyllje të liferimit të pajisjeve rezervë. Në muajin Dhjetor është realizuar pagesa e TVSH. Me datën 14.12.2011 është mbajtur takimi pëmbyllës i projektit në Frankfurt me Intec/KOSTT/Siemens/UMEL. Janë konfirmuar punët e	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

							<p>realizuara; është nënshkruar certifikata finale e pranimit (PC) për NS Peja 3 dhe pjesëve tjera të paket projektit, mbetet të realizohen pagesat nga ana e kFw, pas certifikimit të bërë nga KOSTT-i dhe konsulenca Intec. Në Nëntor është arritur marrëveshja me pronarin e tokës për instalimin e përçuesve në mes shtyllës nr.1 dhe nr.2, gjë që ka ndikuar në futjen në operim të linjës së dyfishtë 110 kV e me këtë edhe të vet NS Skenderaj (më 24.11.2011).</p> <p>Kontraktuesi mbetet që të plotësojë obligimet konform kontratës gjatë periudhës garantuese njëvjeqare: eliminimin e disa vërejtjeve, liferimin e dokumentacionit etj. Në takimin e mbajtur në Frankfurt me 14 dhe 15 Dhjetor iu është nënshkruar vërtetimi i punëve të kryera dhe është lëshuar Certifikata e Pranimit të Përkohshëm (TOC) për NS Skenderaj dhe Linjën e dyfishtë 110 kV, që furnizon këtë nënstacion.</p>	
3	<p><i>Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV</i></p>	700,000.00 €	ECLO	668,500.00 €	17.12.2009	17.10.2011	<p style="text-align: center;">INGEDIA (Ro)</p> <p>Gjatë këtij kuartali konsulenca Ingedia me stafin e vet ka marrë pjesë në mbikëqyrjen e të gjitha punëve që kanë qenë në përfundim e sipër si për LOT 1 ashtu edhe për LOT2 , gjithashtu kanë marrë pjesë në energjizimin e nënstacionit si dhe Linjave të tensionit të lartë 400kV dhe 110kV që është bërë me datën 18.10.2011. Gjatë muajit nëntor konsulenca (me stafin lokal) ka marrë pjesë në mbikëqyrje të punëve, eliminimin e vërejtjeve sipas raportit të komisionit intern KOSTT/Ingedia .</p> <p>Progresi i punëve ka shkuar sipas planit dinamik të punëve dhe fillimi i Tetorit është karakterizuar me një intenzitet të shtuar të punëve, në kompletimin e punëve implementuese të projektit. Janë realizuar testime në vend për pajisjet e instaluar 110kV dhe 400 kV. Me datën 17.10.2011 komisioni intern i KOSTT ka inspektuar punët e realizuara dhe me 18.10.2011 ka deklaruar se linjat e përfundura si dhe</p>	<p>Konsulencës i është kërkuar që të përgadis Raportin Final</p>

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4	<p><i>Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-1:</u> NS 400/110 kV Ferizaj 2</i></p>	15,800,000.00 €	BKK	13,656,000.00 €	24.12.2009	23.10.2012	SIEMENS (At)	<p>nënstacioni 400/110kv Ferizaji 2 mund të energjizohet. Njëherit Siemensit i mbetet që në afat të përmbyll vërejtjet e dhëna nga Komisioni për Pranim Teknik Intern. Inspektimi i punëve është bërë rregullisht nga ana e kompanisë konsultuese INGEDIA dhe stafi i KOSTT. Kontraktuesi gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor ka punuar në drejtim të eliminimit të vërejtjeve të dhëna nga komisioni për pranim teknik intern i KOSTT dhe konsulencia Ingedia. Është nënshkruar dhe lëshuar certifikata e pranimit të përkohshëm (PAC) më 16.11.2011 dhe prej kësaj date fillon periudha garantuuese njëvjeçare.</p>	
	<p><i>Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-2: LP</u> ndërlidhëse 400 dhe 110 kV</i></p>	7,500,000.00 €	ECLO	6,105,000.00 €	31.12.2009	30.10.2011	UMEL (B&H)	<p>Gjatë tremujorit të katërt, punët kanë vazhduar me intenzitet të shtuar dhe sipas planit dinamik të punëve. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve implementuese kryesisht në shtyllat e linjës 110kV Gjilani 5, për të cilat ka pasë probleme të natyrës juridike; problematike kanë qenë shtyllat 71, 72 dhe 73. Për zgjidhjen e çështjeve pronëso-ro-juridike në vazhdimisi është angazhuar stafi i KOSTT me strukturat kompetente të komunës së Gjilanit.</p> <p>Pas arritjes së zgjedhjes së problemit me 28.12.2011 ka përfunduar së ndërtuari edhe linja 110kV NS Ferizaj 2 – NS. Gjilan 5 dhe projekti në tërësi ka përfunduar. Më 21.11.2011, kontraktuesit i është lëshuar certifikata e pranimit parcial të përkohshëm, me ç'rast prej kësaj date fillon periudha</p>	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

								garantuese njëvjeçare, përveç linjës 110 kv, drejtimi NS Ferizaj 2 - NS Gjilani 5, ku periudha garantuese për këtë objekt fillon më vonë (diku në Janar 2012).	
5	<i>Shtërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400kV, Kosovë - Shqipëri</i>	1,200,000.00 €	KfW	1,154,620.00 €	24.09.2009	23.05.2010	INTEC (D)	Gjatë kësaj periudhe tremujorëshe është vazhduar me vlerësimin e ofertuesit më të mirë, ku kane marrë pjesë edhe përfaqësuesit e KOSTT-it dhe kompania konsulente Intec, e angazhuar nga KfW.	
6	<i>Shtërbime Konsulentësh për Projektin SCADA/EMS dhe Telekomini</i>	891,541.00 €	BKK	891,541.00 €	15.01.2008	30.10.2010	KEMA (D)	Me 30.06.2011 konsulenca KEMA ka përfunduar punën sa i përket menaxhimit të projektit SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni. Në shtator kompania konsulente ka dorëzuar Raportin final dhe bazuar në të është realizur pagesa e fundit për punën e kryer sipas kontratës.	
7	<i>Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomini LOT-1: SCADA/EMS</i>	8,500,000.00 €	BKK	7,875,370.00 €	31.12.2008	30.06.2011	Alstom/Komtel (F/RKS)	Sipas planit dinamik projekti është lëshuar në punë me 30.06.2011, por jo i kompletuar. Ka përfunduar Periudha e Disponueshmerise se Sistemit. Është nënshkruar dhe lëshuar Certificata e Pranimit Parcial të Përkohshëm (PPAC), më 04.11.2011, me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njëvjeçare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi është anagzhuar në eliminimin e vërejtjeve nga lista e raportit të komisionit për pranim teknik intern të KOSTT-it.	Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që janë paraqitur nga komisioni për pranim teknik intern duhet të eliminohen brenda afatit të paraparë.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	<p><i>Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekom</i> b) <u>LOT-2: Telekom</u></p>	9,500,000.00 €	BKK	9,214,760.00 €	31.12.2008	30.06.2011	Energoinvest/Alstom(B&H/F)	<p>Sipas planit dinamik projekti është pjesërisht i përfunduar dhe me 30.06.2011 sistemi SCADA/EMS & telekomi . Është nënshkruar deklarata për kompletimin e projektit nga ana e ALSTOM&KOMTEL për përfundimin e punimeve të projektit. Ka përfunduar Periudha e Disponueshmërisë së Sistemit . Certifikata e Pranimit të Perkoshem (parciale) PPAC lëshohet për pjesët e përfunduara , me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njëvjeqare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi duhet të vazhdojë me përfundim të punëve konform kontratës dhe në eliminimin e vërejtjeve nga lista e raportit të komisionit për pranim teknik intern të KOSTT-it.</p>	<p>Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që do të paraqiten nga komisioni intern duhet të eliminohen brenda afatit garantues. Kërkohej nga kontraktori Siemens dhe Areva të realizojnë testin " end to end" të lidhshmërisë së sistemit SCADA /EMS dhe SCDA ne NS Ferizajit</p>
8	<p><u>LOT 1 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS Prishtina 4</u></p>	3,500,000.00 €	KOSTT	2,214,154.00 €	16.06.2009	15.04.2010	Electroputere (BKS/R)	<p>Afatit i garancionit është deri më 30.08.2011. Ekipi për pranim teknik ka dale në teren për verifikimin e vërejtjeve të mbetura dhe ka konstatuar se punët janë kryer. Projekti ka përfunduar dhe janë eliminuar të gjitha vërejtjet . Pritet lëshimi i Certifikatës për Pranim Përfundimtar (FAC), pasi përfundimit të afatit garantues.</p>	
	<p><u>LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajisjeve të TL në NS Prishtina 4</u></p>	800,000.00 €	KOSTT	775,202.37 €	24.07.2009	23.02.2010	SIEMENS (AT)	<p>Afatit i garancionit është deri më 30.08.2011. Ekipi për pranim teknik ka dale në teren për verifikimin e vërejtjeve të mbetura dhe ka konstatuar se punët janë kryer. Projekti ka përfunduar dhe janë eliminuar të gjitha vërejtjet . Pritet lëshimi i Certifikatës për Pranim Përfundimtar (FAC), pasi përfundimit të afatit garantues. Sipas kushteve të kontratës, kontraktuesi ka obligim të bëjë kërkesë për lëshimin e Certifikatës për Pranim Final (FAC) dhe një gjë të tillë nuk e ka bërë. Në momentin kur Menaxheri i Projektit bashk me Komisionin për pranim teknik intern konstatojnë se të gjitha vërejtjet janë eliminuar nga kontraktuesi, atëherë KOSTT lëshon Certifikatën për Pranim Final.</p>	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

9	<p>Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</p>	13,000,000.00€ (LOT1&2)	ECLO	634,000.00 €	05.10.2010	11.07.2012	INGEDIA (Ro)	<p>Kompania konsulente INGEDIA me ekipin lokal në kontinuitet po i përcjell dhe mbikqyrë punët në kuadër të projektit, në bashkëpunim me stafin e KOSTT po aprovon dizajnet si dhe punët në implementim të projektit. Ka marrë pjesë në testimin e pajisjeve në fabrikë -FAT .</p>	<p>Konsulencës i është kërkuar që të jetë më e kujdesshme në rishikimin e dizajnit dhe punimeve ndërtimor.</p>
10	<p><i>Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)</i></p>	10.000.000,00	ECLO	6,308,920.00 €	10.01.2011	09.07.2012	KONCAR (Hr)	<p>Punët në terren janë në vazhdimë sipas planit dinamik të punës të rifreskuar. Gjatë tremujorshit janë zhvilluar punët ndërtimore në NS Prizreni 2 po jo me ndonjë intenzitet të shtuar ,është punuar në betonimin e fushave të linjave dhe fushave transformatorike 110kV. Paisjet e tensionit të lartë të cilat janë testuar në fabrikë janë liferuar dhe janë në TS Prizren 2. Punët po menaxhohen nga stafi i kompanisë konsulente "Ingedia" dhe stafi i KOSTT-it.</p> <p>Ka vonesa në projekt, dhe shkaktar i këtyre vonesave është mosperformimi si duhet i kontraktuesit gjatë implementimit të projektit.</p>	<p>Në mënyrë strikte nga KOSTT është sugjeruar që të angazhohen vetëm nënkontraktues profesional dhe me eksperiencë pasi që natyra e punëve është shumë specifike dhe nën tension. KOSTT ka njoftuar kontraktuesin se nuk mbanë përgjegjësi në rast të aksidenteve nga pakujdesia e kontraktuesit apo nënkontraktuesve.</p>

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	<i>TI për Operimin e Tregut (LOT2)</i>			834,287.00 €	10.01.2011	09.01.2012	Siemens (At)	Gjatë tremujorshit janë realizuar punët konform specifikimit teknik; janë mbajtur trajnimet për stafin e operatorit të tregut; janë liferuar pajisjet hardwerike dhe softwerike. Gjatë muajit Nëntor është mbajtur mbledhja e komitetit drejtues ku janë shqyrtuar mundësitë për realizimin e "Fire Walls" për IT - MO si dhe se si duhet të realizohen "Interface" në mes të IT - MO dhe SCADA, RMC, CAS, Kostt IT, e tjerë, mirëpo nuk është arrit ndonjë progres në këtë drejtim kjo çështje është në proces e sipër, për këtë është informuar edhe Menaxhmenti i lartë i KOSTT si dhe ECLO pritet që të zgjidhet me procedura të Prokurimit, sipas rregullave të ECLO. Projekti ka përfundur sipas planit, mbetet obligim i kontraktuesit të përmbyll vërejtjet Certifiata e Pranimi të Përkohshëm pritet të lëshohet në fillim të janarit 2012. Punët janë menaxhuar nga kompania konsulente dhe stafi i KOSTT-it.	Të sigurohet fondi për sistemin redundat dhe "firewall" të IT Market Operator, nga ana e ECLO-s.
11	<i>Ndërrimi i pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Kosova B ana 400 kV</i>	1.550.000.00 €	KOSTT	1.275.280.00 €	03.08.2010	02.08.2011	Siemens-Monting (At/RKS)	(Punët në kuadër të këtij projekti janë realizuar sipas planit dinamik të punëve; me datën 11.10.2011 ka dal komisioni profesional për pranimin teknik intern të punëve të kryera, me ç'rast ka dhënë disa vërjetje që nuk e pengojnë lëshimin e Certifikatës së Pranimi të Përkohshëm (PAC). Më datën 19.10.2011 është lëshuar Provisional Acceptance Certificate (PAC). Afati garantues fillon prej datës 19.10.2011 dhe zgjatë 12 muaj.	
12	<i>Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3</i>	2,389,000.00 €	KOSTT	1.959.800.80€	01.06.2011	20.12.2011	ELSA&UKAB (Si/RKS)	Është vazhduar me demontimin e shtyllave të vjetra, mirëpo pasi që ende nuk kemi marr pëlqimin (lejen) nga Ministria e Ambientit dhe e Mjedisit, kemi kërkuar nga kontraktuesi që të ndalet me implementimin e projektit. Duhet theksuar se kontraktuesi ende nuk e ka sjell dizajnin/projektin për linjën 110 kV Trepçe-Vallaq, konform Ligjit për Ndërtim dhe Elaboratin e Shpronësimit, konform Ligjit për Shpronësim.	Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

								Projekti ka vonesa në implementim, për shkak se kontraktuesi nuk është duke performuar si duhet në raport me dizajnet/projektet që nevojiten për marrjen e Lejes Urbanistike dhe Ndërtimore. Për këto vonesa kontraktuesi është njoftuar zyrtarisht dhe i është tërhjekur vërejtja se për vonesat që janë shkaktuar nga ai, do të mund të veprojmë konform kushteve të kontratës.	
13	<i>Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)</i>	1,050,000.00 €	KOSTT	1,397,094.32 €	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	Është dërguar dokumentacioni për marrjen e lejes nga Ministria e Ambientit dhe të Mjedisit, pritet që kur të mirret leja të fillohet me implementimin e projektit. Në ndërkohë është bërë demontimi i disa paisjeve të vjetra nga NS Lipjani - 110/35 kV	Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet.
14	<i>Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3</i>	250,000.00 €	KOSTT	168,880.32 €	11.07.2011	02.01.2012	KONCAR-KET (Hr)	Gjatë këtij tremujorshi janë realizuar punët sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës/specifikimit teknik. Janë aprovuar dizajnet dhe realizuar testimet e pajisjeve në fabrikë dhe realizuar trajnimet përkatëse. Është startuar me implementim të projektit dhe projekti është në fazën përfundimtare. Gjatë implementimit është hasur në probleme për realizimin e shkyçjeve. Projekti ka vonesa të vogla, si pasojë e mosigurimit të kushteve për punë nga ana e operimit të sistemit. Projekti pritet të përfundoj në Janar të vitit 2012.	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

15	<i>Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)</i>	150,000.00 €	KOSTT	51,976.60 €	25.09.2011	17.12.2011	ELEGANCA (RKS)	<p>Kanë përfunduar punët implementuese në Linjën 110kV, nr.1801, në linjen 179/1 kanë përfunduar punët pjesërisht 80%, në linjën 126/4 nuk kanë filluar punët akoma për shkak të pa mundësisë së krijimit të kushteve për punë për kontraktuesin;</p> <p>Ka vonesa në projekt si pasojë e pamundësisës së krijimit të kushteve për punë - shkyçjet e linjave</p>
16	<i>Ndarja e zbarrave në dy seksione</i>	150,000.00 €	KOSTT	36,951.57 €	09.08.2011	27.01.2012	UKAB	<p>Është nënshkruar kontrata, projekti është në fazën e fillimit; përgatitjes së dizajnit bazik.</p>
17	<i>Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1 - Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1</i>	4,000,000.00 €	KOSTT	3,267,253 €	02.12.2011	29.06.2012 (120 ditë punë)	Ukab (RKS)/ELSA (Si)	<p>Projekti është në fazën fillestare, me ç'rast është mbajtur Mbledhja Fillestare (Kick Off Meeting).</p>
18	<i>Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV - Kosova B</i>	250,000.00 €	KOSTT	272,409.00	12.12.2011	20.07.2012 (150 ditë punë)	Monting (RKS)	<p>Projekti është në fazën fillestare. Është mbajtur takimi fillestar (Kick Off Meeting). Projekti është në fazën e dizajnit bazik dhe detal.</p>

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

19	<i>Rehabilitimi i pajisjeve të TL 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1</i>	1,150,000.00 €	KOSTT						Është dorëzuar specifikimi teknik në prokurë. Projekti është tenderuar dhe është në proces të vlerësimit të ofertave.	
20	<i>Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2</i>	600,000.00 €	KOSTT						Është përgaditur specifikimi teknik për dy fusha të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2 dhe është dërguar në prokurë për procedurë të metutjeshme.	

	RAPORT TËRREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.4. Çështjet rregullative

Gjatë muajit dhjetor është bërë monitorimi intern për implementimin e Kodeve Teknike. Në bazë të këtij monitorimi është përgatitur **Raporti për monitorim Intern**.

Qëllimi i monitorimit intern për implementimin e Kodeve Teknike, është identifikimi i obligimeve për përmbushjen e të cilave paraqiten vështirësi apo pengesa. Në bazë të konkluzioneve të nxjerra do të planifikohen hapat e duhur për përmbushje të këtyre obligimeve varësisht nga natyra e problemit duke i konsideruar në kategori të ndryshme si:

- Kërkesa për financim
- Kërkesa për amendamentim të dispozitave të caktuara,
- Kërkesa për derogim (shtyrje të afateve) për përmbushje të obligimeve sipas dispozitave përkatëse. Kërkesa për derogim si dhe kërkesat për amendamentim të dispozitave të caktuara, i drejtohen KQKO-se (Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale) e pastaj nga kryesuesi i KQKO-se dërgohet në ZRrE me kërkesë për aprovim

Më 16 dhjetor është dërguar në ZRrE drafti final i dokumentit **Plani Zhvillimor i Transmisionit (PZhT) 2012 - 2021**, i cili është aprovuar nga ZRrE me datën 29 dhjetor.

Me datën 14 nëntor KOSTT ka marrë nga KEK një shkresë zyrtare të titulluar: *Faturat për Ngarkesat e Transmisionit për tetor 2011*.

Përmes të kësaj shkrese KOSTT është udhëzuar nga KEK për mënyrën e faturimit. Sipas kësaj shkrese, fatura për muajin tetor nuk mund të kalojë vlerën prej 223,873.92 euro, dhe duke llogaritur humbjet në transmision për tetor të kalkuluara në vlerë prej 202,094.60 euro, diferenca duhet të jetë 21,824.32 euro.

Lidhur me shkresën e datës 14 nëntor, me datë 16 nëntor KOSTT ka dërguar shkresën kthyesë në KEK dhe një kopje në ZRrE, ku edhe janë dhënë sqarime për çështjet e ngritura nga KEK, është theksuar baza ligjore dhe janë dhënë propozime konkrete për zgjidhje të kësaj çështje në mënyrë bilaterale dhe në bazë të parimeve të njohura nga të dy palët.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Me datë 21 nëntor, në vazhdim të mosmarrëveshjeve, KOSTT ka marrë edhe një deklaratë në formë elektronike të bërë nga KEK sh.a. në të cilën është theksuar se **Profakturat për muajin tetor 2011 janë të papranueshme.**

Lidhur me këtë, me datë 24 nëntor KOSTT ka dërguar një shkresë në ZRrE përmes së cilës ka bërë njoftim për situatën aktuale dhe ka kërkuar që ZRrE të ndihmon në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Njëheritë është theksuar se kjo situatë e cila po vazhdon ka implikime negative për KOSTT si dhe ndikon direkt në raportime të pasakta financiare dhe tatimore.

Me date 12 dhjetor ZRrE ka dërguar një shkresë të drejtuar për KEK-un, si përgjigje ndaj shkresës së KOSTT të datës 24 nëntor lidhur me mosmarrëveshjet me KEK-un për pagesën e faturave për ngarkesat e Transmisionit për muajin tetor 2011.

Në mbledhjen e Bordit të ZRrE të mbajtur me datë 29 dhjetor është shqyrtuar edhe kontesti KOSTT-KEK lidhur me mospagesën e faturave të KOSTT nga ana e KEK. Jami në pritje të një vendimi nga kjo mbledhje e Bordit të ZRrE.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.5. Shqyrtimi i performancës financiare

2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

Bilanci i gjendjes	Nota	Janar-Dhjetor/2010	Janar-Dhjetor/2011	%
ASETETE JO QARKULLUESE		88,827,517	95,561,458	108%
Prona, Fabrika dhe Paisjet	4	88,791,747	94,104,359	106%
Aktiva afatgjate jo materiale	5	35,770	1,457,099	
ASETET QARKULLUESE		32,035,000	30,255,799	94%
Stoqet,pjesët rezervë dhe veglat	6	906,771	1,678,070	185%
Kërkesat	7	9,389,785	6,635,034	71%
Kredi,Avanse dhe Depozita	8	6,887,535	3,015,345	44%
Tatimi i Parapaguar		-	321,867	
Paraja dhe Bilanci Bankar	9	14,850,064	18,605,482	125%
TOTALI I MJETEVE		120,862,517	125,817,257	104%
KAPITALI I AKSIONARËVE DHE REZERVAT		42,456,386	42,958,167	101%
Kapitali Aksionar	10	25,000	25,000	100%
Kapitali i trashëguar	11	28,346,963	28,346,963	100%
Fitimi i mbajtur		10,616,616	14,084,667	133%
Fitimi aktual		3,467,808	501,537	14%
OBLIGIMET JO QARKULLUESE		68,392,339	75,413,685	110%
Të hyrat e shtyera	12	68,392,339	75,413,685	110%
OBLIGIMET QARKULLUESE		9,012,947	7,445,405	83%
Obl.nga tregtia dhe obl.tjera	13	9,012,947	7,445,405	83%
TOTAL BURIMET E MJETEVE		119,861,672	125,817,257	105%

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

DRAFT PASQYRA E FITMIT DHE HUMBJES

	Nota	Plani Janar-Dhjetor 2010	Realiz. Janar-Dhjetor 2010	% real/plani 2010	Plani Janar-Dhjetor 2011	Realiz. Janar-Dhjetor 2011	% real/plani 2011	% realiz 2011/2010
Të hyrat nga tarifa	15	18,309,867	20,075,727	110%	14,230,218	14,706,299	103%	94.26%
Të hyrat tjera	16	0	2,649,000		2,920,000	4,084,534	140%	
Të hyrat totale		18,309,867	22,724,727	124%	17,150,218	18,790,832	110%	88.28%
Shpenzimet e personelit	17	2,652,813	2,647,719	100%	2,670,681	2,817,473	105%	105.70%
Shpenzimet e materialit		52,000	36,946	71%	52,000	44,616	86%	120.76%
Kompenzimet Bordi i drejtove			75,033			88,642		
Rregullimi sekondar		1,623,900	1,600,000	99%	-	-		
Amortizimi	4	5,200,000	4,865,529	94%	5,200,000	6,349,626	122%	130.50%
Energjia, telefoni, uji		211,000	225,765	107%	229,000	244,777	107%	99.90%
Riparime dhe mirëmbajtje	18	921,243	752,366	82%	1,113,489	742,709	67%	81.67%
Derivate dhe lubrifikante		93,202	75,823	81%	93,202	88,149	95%	116.26%
Medicina, siguria dhe transporti	20	293,000	249,128	85%	312,000	194,139	62%	73.18%
Shpenzimet tjera operative	19	690,582	959,550	139%	1,200,018	756,199	63%	45.35%
Kompenzimet tjera.		98,000	12,644	13%	100,000	38,462	38%	298.10%

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 32 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Humbjet në bartje	21	5,479,807	4,319,081	79%	4,019,475	3,578,893	89%	112.97%
Provizioni i kërkesave kontestuese			2,764,339			3,345,610		
Shpenzimet totale		17,315,547	18,583,922	107%	14,989,865	18,289,295	122%	113.68%
Fitimi para Tatimit		994,320	4,140,805	416%	2,160,353	501,538	23%	5.57%
Tatimi ne fitim	22		673,000					
Fitimi për periudhë		994,320	3,467,805	349%	2,160,353	501,537	23%	6.66%

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare

IKP-të financiare të zgjedhura për të paraqitur performancën financiare të KOSTT-it, janë të matshëm në baza vjetore dhe në baza kuartale. Indikatorët e paraqitur në këtë tabelë janë të matshëm në baza kuartale.

Treguesit	I-XII 2010	I-XII 2011	Spjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto / gjithësejt të hyrat	0.18	0.03	Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese. Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.
T2. Treguesi i qarkullimit = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese	3.55	4.08	Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është 1.5 .
T4. Mbulimi i shp.operative = gjith.të hyrat/shpenzimet operative	1.21	1.03	Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara. Treguesi duhet të jetë më i madh ose = 1
T5. Mbulimi i të hyrave = gjith.s.të hyrat/ shpenzimet e lejuara	1.29	1.25	Treguesi duhet të jetë më i madh ose = 1

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T6. Mbulimi i shp. të lejuara = shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat	0.77	0.80	Treguesi duhet të jetë më i vogël se 1 ose = 1
T7. Gjith. të hyrat ndaj të hyr. të lej = gjith. të hyrat e rregulluara/të hyrat e lejuara	1.22	1.10	Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara. Treguesi duhet të jetë = 1. Për shak të rrjedhave më të mëdha të energjisë, treguesi është më i madh se 1.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

3. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

Nr	Lënda nr.	Pranë	Objekti i kontestit	Vlera e kontestit	Statusi	Statusi	
1	Lënda Civile nr. 2248/03	Gjykata Komunale në Prishtinë	dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës	92,000.00	Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës	Seanca e caktuar për dt.14.07..2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Aktgjykimi.	Seanca 01.04/11, shtyhet dhe seanca e dt.21.04 për dt.12.05/11.
2	Lënda penale nr.326/05	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	2,370.00	Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01;shtyhet 30.03.2009...	Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtë Aktgjykimi.-është pranuar, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009)	Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer.
3	Lënda Civile nr.85/05	Gjykata Komunale në Prishtinë	kompensim i dëmit	50,000.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008	Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009, Mbahet seanca përfundimtare dt.11.06.2009.Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit.	Lënda me Ankesë në GjQ.
4	Lënda civile C1.nr.505/07	Gjykata Komunale në Prishtinë	pagesa e kamatës ligjore	nuk ka	Përfaqësuesi i KEK-ut, ka refuzuar pjesëmarrjen në seanca pa prezencën e KOSTT-it.	Është caktuar seanca me dt.01.04.2009,shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010.	Aktgjykimi nuk është i formës së prerë

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

5	Lënda penale nr. 2406/ 06	Gjykata Komunale në Prishtinë	vjedhje	15,398.00	Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm	Nuk kemi njoftim ende për formën e prerë.	Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të Paditurve, nga dt.12.06, do t'i dorëzohet me polici
6	Lënda penale nr.320/06	Gjykata Komunale në Kaqanik	vjedhje e rëndë	9,120.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008	Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi	Aktgjykimi me Ankesë, ne GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010.
7	Lënda penale 284/06	Gjykata Komunale në Lipjan	vjedhje e rëndë	Nuk është përcaktuar	KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit)		.Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut.
8	Lënda civile nr. 409/06	Gjykata Komunale në Prishtinë	Lirimi i banesës	nuk ka	Seanca e rradhës nuk është mbajturur, pritet caktimi i seancës tjetër	Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10(ditë pushimi).	Seanca e rradhës nuk është caktuar ende.
9	Lënda civile nr.511/00	Gjykata Komunale në Prishtinë	lirimi i lokaleve në Kurriz	nuk ka	Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë	Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim.	Ende nuk është kryer.(Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda me Ankesë GjQPr.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

10	Lënda civile nr. 2168/04	Gjykata Komunale në Prishtinë	lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz	nuk ka	Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008	Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit.	Seanca e rradhës me dt.17.04/09,(Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata
11	Lënda civile C.nr.588/08	Gjykata Komunale në Gjakovë	Kompenzim dëmi	1719.04	Seanca u caktua për dt.19.01.2009	Seanca e rradhës në afat të pacaktuar	KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009.
12	C.156/09	Gjykata Komunale Prizren	Kompenzim dëmi		I parashtruar me dt.11.03/09.		Pritet caktimi i seancës se radhes.
13	Lëndë Civile C.nr.442/09	Gjykata Komunale-Prizren	Pengim posedi	500		Seanca mbahet dt.11.11/09,11,30h; shtyhet 02.12/10;14.12; 25.05...e fundit dt.07.06/11.	Gjykata bie Aktgjykimin në favor të KOSTT-it, dt.15.07.2011, lënda me ankesë GjQ.
14	Lëndë civile , Padi	Gjykata Komunale Ferizaj	kompenzimi i dëmit	200,00€	Padia e dorëzuar në Gjykatë 26.06/09	Pritet caktimi i seancës.	Të hiqet nga agenda për shkak të vonesave dhe vlerës së vogël
15	C.nr.1559/06	Gjykata Komunale Prishtinë	pagesa e Rentës.		KEK ka paguar - Qershor/2006.	Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10	KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv.
16	C.nr. 270/07	Gjykata Komunale Podujevë	Kompenzim dami	100.000,€	KOSTT- i padituri III-të (Tretë)	seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorëzimi i shkresave të lëndës KOSTT-it	Seanca e rradhës sipas ftesës.
17	A.nr.888/10	Gjykata Supreme e Kosoves	Vlersimi për TP	14.000,€	Ankesa e KOSTT-it pjesërisht e aprovuar nga Bordi Komun.	KA i parashtruar në afat ligjor	Lënda e kryer nga Gj.Supreme.Aktgjykimi i bazuar nga kërkesa e KOSTT-it.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 38 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

18	C.nr.218/11	Gjykata Komunale Ferizaj	Pengim Posedi	500 €	KOSTT- ka parashtrua Përgjigje në Padi sipas Aktvendimit të Gjykatës	Seanca e dt. 20.06/11, shtyhet me 04.07; shtyhet me 05.09/11.Seanca e rradhës dt.27.10/11	Lënda e kryer në Shkallën e I-rë. KOSTT-parashtron Ankesë Gj.Qarkut-PR.
19	C.nr.503/11	Gjykata Komunale Pejë	Pengim Posedi	nn	Sipas kërkesës së Gjykatës KOSTT ka parashtrua precizimin e Padisë.	Pritet ftesa për seancë(para seancës sqarime me Gjyqtarin)	
20	C.nr.2255/06	GjK-Prishtine	Kompenzim dëmi	nn	Sipas kërkesës së të Autorizuarit të Paditëses me zgjerim të Padisë	Përgjigja në Padi sipas Akt. Gjyqësor u dorëzua 12.11.2011.	Seanca Gjygsore sipas ftesës.

Sqarim:

Lënda A.nr.888/10, Lënda e kryer nga Gjykata Supreme . Aktgjykimi i bazuar nga kërkesa e KOSTT

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të katërt të vitit 2011 nga burimet e KOSTT

Departamenti	Tipi i Prokurimit	Emri i Projektit	KONTRAKTORËT	Vlera e Kontratës	Vlera e Realizuar e Kontrates	Vlera e mbetur për realizim	Përqindja e Realizimit	Nr. i Protokolit
Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Furnizim	Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP212 (Kosova A – Ferizaj)	UMEL DALEKOVODMONTAZA	1,397,094.72 €	209,564.21 €	1,187,530.51 €	15.00%	nr.194 dt.01.06.2011
Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Furnizim	Ndërrimi i përcësist, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP: 125/2,125/3	konz.ELSA-UKAB	1,959,800.80 €	892,338.08 €	1,067,462.72 €	45.53%	nr.200 dt.08.06.2011
Departamenti i OT	Furnizim	Furnizim me pjese rezerve per mirembajtje te linjave dhe nenstacioneve	UKAB	185,397.80 €	176,692.79 €	8,705.01 €	95.30%	nr.229 dt.06.07.2011
Departamenti i Burimeve Njerëzore	Shërbime	Sigurimi Fizik i Objekteve të KOSTT sh.a.	LEO SECURITY	338,791.68 €	106,760.80 €	232,030.88 €	31.51%	nr.88 dt.21.03.2011
Departamenti i OT	Punë	Perforcimet mekanike dhe elektrike ne linja konform situatave te krijuara ne teren	Eleganca Com	250,000.00 €	- €	250,000.00 €	0.00%	nr.345 dt.04.11.2011
Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Punë	Rehabilitimi i Pajisjeve për shpenzime vetjake në NS Kosova B	Monting	272,409.00 €	- €	272,409.00 €	0.00%	nr.359 dt.11.11.2011
Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Furnizim	Rehabilitimi i Stabilimenteve të Tensionit të Tensionit të Lartë në NS Ferizaj dhe NS Gjilan	EnBi Power	960,031.00 €	- €	960,031.00 €	0.00%	nr.06 dt.18.01.2012
Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Furnizim	Rialokimi i linjës LP 1806 NS Gjakovë 1 – NS Gjakovë 2 dhe Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Gjakova 1	konz:Ukab-Bohemia Muller-Elsa	3,267,253.00 €	- €	3,267,253.00 €	0.00%	nr.345 dt.03.11.2011
Departamenti i OT	Shërbime	LOT 2 : Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve, tipi : Toyota, Nisan, Landrover dhe te	Renault Centre	240,000.00 €	- €	240,000.00 €	0.00%	nr.363 dt.14.11.2011
Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Furnizim	Instalimi i dy fushave te reja te linjave 110kV ne NS 220110 kV PRizreni 2	UKAB	551,998.00 €	82,800.00 €	469,198.00 €	15.00%	nr.05 dt.18.01.2012
TOTALI				9,422,776.00 €	1,468,155.88 €	7,954,620.12 €	15.58%	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Shtojca 1: Raport mbi funksionimin e Qeverisjes Korporative të KOSTT-it

Ky Raport përfshin aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi gjatë periudhës Tetor –Dhjetor 2011. Gjatë periudhës raportuese Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur 3 mbledhje, kurse Komisioni i Auditimit gjithashtu ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta. Komisioni i Bordit për Projekte Kapitale dhe Komisioni i Bordit për ndarjen e asetëve në mes të KEK- KOSTT kanë mbajtur nga një mbledhje.

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe të Komisionit të Auditimit janë caktuar në periudhat kohore sipas Planit të aprovuar të Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2011.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten në çdo mbledhje si pika të rëndomta dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimi i rendit të ditës nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Procesverbaleve nga mbledhjet e komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Informata rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshëfit Ekzekutiv (KE) të KOSTT-it. Mbledhjet në vijim janë paraqitur sipas datës së tyre.

1. Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 22/11

Komisioni i Auditimit në mbledhjen nr. 22/11 e datës 26 Tetor 2011 ka shqyrtuar dhe rekomanduar Bordit për aprovim: Planin e Biznesit dhe Buxhetin për vitin 2012. Komisioni ka vlerësuar se Plani i Biznesit përmban të gjitha elementet e duhura dhe se për ndryshim nga vitet e kaluara, në Plan janë përkrahur edhe sfidat me ndryshimet e Buxhetit dhe mjetet që janë planifikuara për kryerjen e objektivave. Aktivitetet e

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 41 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

planifikuara dhe mjetet janë precizuar mjaft mirë. Komisioni ka vlerësuar se Biznes Planin dhe Buxheti për vitin 2012 i plotësojnë kushtet që të vlerësohen nga Bordi i Drejtorëve dhe pas shqyrtimit të aprovohen.

Komisioni i Auditimit gjithashtu ka shqyrtuar Manualin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Komisioni në vazhdimësi ka vlerësuar ndryshimet dhe plotësimet e Politikës së Rekrutimit dhe Selektimit, Politikën e pushimeve, Politikën mbi orarin e punës, Kodin Disciplinor, Politikën mbi nivelin e autorizimit të KOSTT-it dhe Politikën mbi shfrytëzimin e telefonave mobil. Komisioni ka konstatuar se plotësimet dhe ndryshimet e bëra në politikat e propozuara, janë konform Ligjit të punës dhe në aspektin profesional dhe përmbajtësor janë të punuara mjaft mirë dhe i përmbajnë referencat ligjore.

2. Mbledhja e rregullt e Bordit nr. 22/11

Bordi në mbledhjen nr. 22/11 e datës 28 Tetor 2011 ka shqyrtuar Planin e Biznesit dhe Buxhetin për vitin 2012. Plani i Biznesit dhe Buxheti janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar dhe Bordi ka kërkuar disa shpjegime shtesë nga menaxhmenti i KOSTT-it. Pas vlerësimit të materialit të prezantuar Bordi ka konstatuar se këto dokumente janë përpiluar në mënyrë të duhur, konform ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare dhe i ka aprovuar.

Bordi gjithashtu ka aprovuar Manualin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, Politikën e Rekrutimit dhe Selektimit (ndryshimet dhe modifikimet konform Ligjit të punës), Politikën e pushimeve (ndryshimet dhe modifikimet konform Ligjit të punës), Politikën mbi orarin e punës (ndryshimet dhe modifikimet konform Ligjit të punës), Kodin Disiplinor (ndryshimet dhe modifikimet konform Ligjit të punës).

Bordi me rekomandimin e Menaxhmentit të KOSTT-it ka vendosur që Politikën mbi nivelin e autorizimit të KOSTT dhe Politikën mbi shfrytëzimin e telefonave mobil t'a shqyrtoj në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Bordi gjithashtu e ka shqyrtuar edhe Letrën e menaxhmentit për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2010.

Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit për linjën 400 kV Kosovë – Shqipëri nr. 4 dhe Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit për Projektet Kapitale nr. 5.

3. Mbledhja e Komisionit të auditimit Nr.23/11

Komisioni i Auditimit në mbledhjen nr, 23/11 e datës 17 Nëntor 2011 ka shqyrtuar Raportin tremujor Q3 për periudhën Korrik-Shtator 2011. Duke e shqyrtuar raportin, Komisioni në lidhje me Bilancin Elektroenergjetik të planifikuar dhe me disa pozicione të tjera relevante, ka konkluduar se janë përmbushur objektivat e planifikuara në krahasim me realizmin, ndërsa humbjet në transmision janë zvogëluar. Indikatorët kyç tregojnë performancë pozitive ndërsa nuk ka pasur ankesa gjatë periudhës raportuese. Pas vlerësimit të Raportit, Komisioni ka rekomanduar Menaxhmentit të KOSTT-it që i njëjti t’i dërgohet Bordit për shqyrtim dhe aprovim.

Komisioni ka shqyrtuar edhe Planin e Prokurimit për vitin 2012 dhe ka kërkuar që ky Plan t’i dërgohet Bordit për shqyrtim dhe aprovim. Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar dhe aprovuar: Planin Strategjik për Auditim të Brendshëm 2012 - 2014, Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2012 dhe Raportet e Auditimit të Brendshëm. Komisioni u njoftua për Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare Rregullative sipas kërkesës nga ZRrE.

4. Mbledhja e Bordit nr 23/11

Bordi në mbledhjen nr, 23/11 e datës 25 nëntor 2011 ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin tremujor Q3 për periudhën Korrik-Shtator 2011. Bordi së pari ka dëgjuar komentet e Komisionit të Auditimit dhe nga Menaxhmenti i KOSTT-it ka kërkuar sqarime për disa pika të Raportit. Pas vlerësimit, Bordi ka konstatuar se Raporti

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

tremujor i përmban elementet e duhura ligjore dhe është përpiluar sipas standardeve të kontabilitetit. Sipas Raportit të prezantuar janë realizuar të gjitha objektivat e parapara me plan por edhe janë tejkaluar në disa pozicione, janë përmbushur të gjitha IKP-të, si teknike ashtu edhe ato financiare.

Bordi në vazhdim të mbledhjes ka shqyrtuar dhe aprovuar Planin e Prokurimit për vitin 2012. Bordi u informua nga Menaxhmenti i KOSTT-it për Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare rregullative sipas kërkesës nga Zyra e Rregullatori të Energjisë pa kualifikime.

5. Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 24/11 e datës 20 Dhjetor 2011

Komisioni në mbledhjen e vet të rregullt të datës 20 Dhjetor 2011 ka shqyrtuar Raportin për rezultatet financiare dhe performancën e KOSTT-it gjatë periudhës shtator-dhjetor 2011 dhe Raportin mbi Përmbushjen e Nevojave të Konsumatorëve për vitin 2011. Këto dokumente i janë rekomanduar për aprovim Bordit në mbledhjen e ardhshme. Komisioni ka shqyruar edhe Politikën mbi nivelin e autorizimeve në KOSTT (plotësimet dhe ndryshimet) dhe Politikën për shfrytëzimin e telefonave mobil (plotësimet dhe ndryshimet) dhe ka rekomanduar që këto t'i dërgohen Bordit për shqyrtim dhe aprovim.

6. Mbledhja e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it nr. 24/11

Bordi në mbledhjen e vet të rregullt të datës 21 Dhjetor 2011 ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin për rezultatet financiare dhe performancën e KOSTT-it gjatë periudhës shtator-dhjetor 2011 dhe Raportin mbi Përmbushjen e Nevojave të Konsumatorëve për vitin 2011. Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar edhe Politikën mbi nivelin e autorizimeve në KOSTT (plotësimet dhe ndryshimet), Politikën për shfrytëzimin e telefonave mobil (plotësimet dhe ndryshimet) dhe ka aprovuar

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

kërkesën e KOSTT-it për vlerësim të performancës së menaxhmentit të KOSTT-it në baza vjetore.

7.Mbledhjes nr 6 e Komisioni i Bordit për Projektet Kapitale

Mbledhja e Komisionit të Bordit për Projekte Kapitale e mbajtur me 20.12.2011 kishte për qëllim që Komisioni të informohet për statusin e projekteve kapitale. Rendi i ditës ka përfshirë shqyrtimin/aprovimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, vlerësimin e dinamikës së realizmit të projekteve kapitale dhe analizën e statusit të implementimit të projekteve kapitale në vlerë fizike dhe financiare për vitin 2011. Të pranishmit u njoftuan se NS Skenderaj bashkë me linjën e dyfishtë 110 kV është lëshuar në punë provuese (është energjizuar). Nga takimi i fundit që është mbajtur në Frankfurt me Siemens/Umel dhe Intec, KOSTT ka arritur që Linja e Skenderajt bashkë me NS Skenderaj të përfshihen në garancion, edhe pse i ka kaluar kohëzgjatja për shkak të vonesave të shkaktuara nga palët e treta. Garancioni për këtë pjesë të projektit përfundon me datën 22.11.2012.

Sa i përket rindërtimit të NS 220/110 kV – Prizreni 2, ky projekt po rrjedh sipas planit dinamik dhe nuk ka ndonjë problem në këtë drejtim.

Të pranishmit u njoftuan edhe për rrjedhën e projekteve kapitale që financohen nga KOSTT –i dhe për shumicën e tyre në këtë periudhë raportuese është bërë pagesa e avansit në vlerë prej 15% të çmimit të kontratës. Nga Buxheti i Kosovës për projekte kapitale për 2011, janë realizuar 89.89 %, gjë që dëshmon përkushtimin e KOSTT-it që projektet kapitale të implementohen me kohë dhe në mënyrë të duhur.

8. Mbledhja nr. 5 e Komisionit te Linjet 400 kV

Komisioni në mbledhjen e datës 21.12.2011 është njoftuar me progresin në lidhje me projektin e linjës 400 kV Kosovë – Shqipëri. Menaxhmenti i KOSTT-it e ka informuar Komisionin mbi zhvillimet lidhur me implementimin e Projektit të Linjës 400 KV si dhe me detyrat e mëtejme.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Raporti i prezantuar me shkrim nga Menaxhmenti i KOSTT-it ka përfshirë aktivitetet lidhur me projektin nga aspekti komercialo-financiar, aktivitetet rreth implementimit dhe planet për vitin 2012.

Në lidhje me aktivitetet komercialo-financiare u raportua fillimi i pagesës së obligimeve të KOSTT nga Marrëveshja për Financim të projektit në fjalë, që lidhen me dispozitat e sigurisë së huasë. Për sa i përket adendumit të kontratës për shërbime konsulente, u raportua rimbursimi ndaj kontraktorit për fazën e parë të shërbimeve të kryera. Në lidhje me implementimin e projektit janë zhvilluar disa aktivitete nga konsulentët e KfW-së, ofertat janë hapur, evaluimi është kryer në tërësi dhe 4 kompani janë parakualifikuar. Pritet që së shpejti në mes të OST dhe KfW të bëhet kontraktimi. Plani i raportuar në Korrik 2011 do të pësojë ndryshime pasi nuk u arrit të realizohet. Arsyeja e vonesave lidhet me ndryshimet në menaxhmentin e OST-it të cilat ndryshime nuk kanë lejuar përshtatjen me dinamikën e projektit duke marrë kohë shtesë për vendime. Për vitin 2012 planifikohet të realizohet kontraktimi në Janar/Shkurt 2012 dhe implementimi i projektit

9. Aktivitete të tjera

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efikasitet më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 46 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Lista e shkurtesave

ATR – Autotransformatori

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

ECLO – (nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

GjQ – Gjykata e Qarkut

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

KA – Konflikt Administrativ

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

LP – Largpërçuesi

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managment System) -Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

TP – Tatimi në pronë

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë